



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “F & M Reklama”shpk**  
**Adresa:** Tirane Vaqarr PRUSH Njesia Administrative Vaqarr, Rruga  
"Prush", Zona Kadastrale 3064, Pasuria Nr.151/57

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”** në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 34 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) kreu IV, Neni 39.

**Referenca e procedures:** REF-73845-10-02-2020.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është:** “Blerje shërbimi për realizimin e projektit, “Fillo me një ide-Fito një intership në Bashkinë e Tiranës”.

**Fondi limit: 980.790 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.**

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 15.10.2020**

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 85 datë 12 Tetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë -

**1. Operatori ekonomik «F & M Reklama» shpk NUIS L31716006E**

Vlera e ofertës pa TVSH– 961.174 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

**2. Operatori ekonomik «Lizard» shpk NUIS L01508026P**

Vlera e ofertës pa TVSH– 972.300 (nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind) lekë

Është s'kualifikuar operatori ekonomik "Lizard" shpk per arsyet si më poshtë vijon:

Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2, gërma "dh", përcaktohet se: "Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:[...] e.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri". Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese". Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..." Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me **Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011** "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që: "**Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**"

Nga dokumentacioni i mësipërm konstatohet se shoqëria "Lizard" sh.p.k mbështetur ne vërtetimin e OSSHE me Nr 3323 prot dt 21.09.2020 rezulton të ketë të papaguar faturën e muajit Gusht 2020. Lidhur me këtë fakt, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjykon se operatori ekonomik "Lizard" sh.p.k nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi procedura e prokurimit është publikuar në datën 05.10.2020, dhe hapja e ofertave është zhvilluar në datën 15.10.2020, kohë në të cilën operatori ekonomik në fjalë kishte mundësinë e likuidimit të faturës së energjisë elektrike për muajin Gusht 2020 në mënyrë që të përmbushte kriteret për kualifikim. Operatori ekonomik "Lizard" shpk, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, nuk ka vërtetuar se ka shlyer të gjitha detyrimet e matuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Gusht 2020, data maksimale përfundimtare për shlyerjen e të cilit, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte data 30.09.2020. Në Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 përcaktohet se: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore..... jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar" cka do të thotë se afati 30.09.2020 është dita e fundit për shlyerjen e këtij detyrimi. Ofertuesit e mundshëm dhe në rastin konkret shoqëria "Lizard" shpk e cila ka shprehur interesin për të marrë pjesë në këtë procedurë kishte kohë të mjaftueshme për likuidimin e detyrimit për muajin Gusht 2020 pasi detyrimi nuk mund të shlyhet pas datës 30.09.2020.

2. Operatori ekonomik "Lizard" shpk nuk ka paraqitur certifikatën ISO 14001: 2015 "mbi sistemet e menaxhimit të ambientit" duke rene ndesh me kërkesën për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.8 në rubrikën "Kapaciteti teknik" dhe si rrjedhojë edhe me VKM nr 914 dt 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (I ndryshuar) neni 30 "Kërkesat e çelësive".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "F & M Reklama" shpk** me adresë: Tirane Vaqarr PRUSH Njesia Administrative Vaqarr, Rruga "Prush", Zona Kadastrale 3064, Pasuria Nr.151/57 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 961.174 (**nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.10.2020.**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”( i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.